



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

(PROPOZIM)

PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

Lipjan, Shkurt 2018

RAPORTI I PUNËS SË GRUPIT PUNUES

Me Vendimin e Kryetarit të Komunës 1Nr.351-2969 të datës 24.01.2017 është formuar Grupi Punues për hartimin e projekt-planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën publike, në këtë përbërje:

1. Bajram Sinani -Kryesues
2. Ilir Shala -Anëtar
3. Behar Krasniqi -Anëtar
4. Kushtrim Salihu -Anëtar
5. Jeton Zymeri -Anëtar

Grupi punues ka hartuar planin duke u bazuar në dokumentet dhe veprimet e mëposhtme:

1. Rregullorja 15Nr.011-5823 e datës 01.02.2016.për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.
2. Informatat nga Drejtorati për Shërbime Publike mbi sipërfaqet e shfrytëzuara.
3. Analizë nga vizita në teren.
4. Konsultimet në kuadër të Grupit punues dhe me organet e tjera komunale.

Raporti është ndarë në katër (4) pjesë :

- I.** Hyrja
- II.** Plani i vendosjes së objekteve të përkohshme në hapësirat publike.
- III.** Propozim për shfrytëzim dhe menagjim të hapësirave të publike.
- IV.** Pjesa përfundimtare.

I.HYRJA

Miratimi i planit mbështetet në nenin 17 të Rregullores 15Nr.011-5823 e datës 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Qëllimi i miratimit të planit është që konform Rregullores dhe legjislacionit në fuqi të përcaktohen lokacionet e përshtatshme të pronave publike për vendosjen e objekteve të përkohshme siq përcaktohen në nenin 4 të Rregullores së cekur më lartë. Gjithashtu plani miratohet me qëllim të krijimit të qartësisë ligjore për mënyrën e veprimeve në rastet e shqyrtimit të kërkesave të palëve (personave fizik dhe juridik) për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronat publike.

II.PLANI PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Plani përmbanë pjesën tekstuale dhe grafike.

Pjesa tekstuale:

Duke u bazuar në kushtet e përgjithshme teknike vendosja e objekteve dhe plani i vendosjes bazohet në llojin e objektit të përkohshëm.

Llojet e objekteve të përkohshme sipas këtij plani janë :

- 1.Paisjet reklamuse dhe informuese
2. Qoshqet
3. Objektet e përkohëshme montuese
4. Paisjet Lëvizëse.
- 5.Terasat Hoteliere.
6. Mbulesat për strehimin e njerzve në transportin publik.
7. Paisjet për lorjash fëmijësh.
- 8.Antenat satelitore.
- 9.paisje të tjera të ngjashme dhe objekte të cilat sipas kushteve të kësaj rregulloreje kanë karakterin e objekteve të përkohshme.

PAISJET REKLAMUSE DHE INFORMUESE

Paisjet informuese dhe reklamuse janë objektet që do të vendosen nëpër qytet, në vendndalimet e autobusëve të cilat shërbejnë si vend reklamimi, gjithashtu sipërfaqet e qoshqeve mund të shfrytëzohen për reklamim pas sipas procedurave të parapara me nenin 16 të rregullores.




Paisjet-panot reklamuse sipas Rregullores mund të vendosen në fasadat dhe kulmet e ndërtesave(muralet, panot, reklammat elektronike përmes së subjektet-kompanitë afariste promovojnë aktivitetet e tyre. Po ashtu panot reklamuese mund të vendosen në hapësirat e përshtatshme pranë rrugëve por që nuk pengojnë zhvillimin e rregulltë komunikacionit.

Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme duhet që fillimisht prona publike bazuar në nenin 16 të Rregullores të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunale dhe zbatimit të ankandit publik.

Pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, DPUMM lëshon leje për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Në skicën e mëposhtme janë paraqitur lokacionet e përshtatshme për vendosjen e panove reklamuese të cilat njëkohësisht janë pronë e rrugëve dhe pronë publike nën menaxhim të komunës.



Një formë e mundshme e panos reklamuese që do të jetë unike në tërë komunën e Lipjanit është paraqitur në foton e mëposhtme.



OBJEKTET E PËRKOHSHME MONTUESE-QOSHQET, KIOSKAT DHE PAISJET LËVIZËSE.



QOSHQET

Në bazë të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike mund të vendosen objekte të përkohshme (qoshet) të cilat punohen nga materiali i lehtë me sipërfaqe deri në 15m² dhe lartësi deri në 2.20m, që do të shërbejnë për shitjen e gazetave, fletushkave dhe gjësendeve të imta.

Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkohshme duhet që fillimisht prona publike bazuar në nenin 16 të Rregullores të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunale dhe zbatimit të ankandit publike.

Pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, DPUMM lëshon leje për vendosjen e objekteve të përkohshme.

Foma e objekteve të përkohshme-Qoshqeve është paraqitur si në vijim:



1. Lokacioni i parë është pranë stacionit të autobusëve ana e djathtë e rrugës me katër korsi” Haradin Bajrami”.
2. Lokacioni i dytë është pranë stacionit të autobusëve ana e djathtë afër Sallës së sporteve” Beter Life” rruga “ Bajram Gashi”.
3. Lokacioni i tretë është pranë stacionit të autobusëve ana e djathtë përballë Shtëpisë së Kulturës” Tahir Sinani” rruga “Avdi Kelmendi”.

OBJEKTET E PËRKOSHME MONTUESE (KIOSKAT)

Janë objekte të përkoshme të cilat mund të jenë me sipërfaqe deri në 30m² dhe lartësi nga 2.5 deri në 3.5 metra. Këto objekte të përkoshme duhet jenë të një forme, madhësie dhe me pamje të njëjtë në tërë qytetin e Lipjanit.

Shënim: Për vendosjen e këtyre objekteve të përkoshme duhet që fillimisht prona publike bazuar në nenin 16 të Rregullores të ipet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronave publike-komunale dhe zbatimit të ankandit publike.

Pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, DPUMM lëshon leje për vendosjen e objekteve të përkoshme.

Lokacioni i vendosjes është hartuar në atë mënyrë që të llogariten distancat nga objekte afariste private për të cilat mund të ndikojnë në rrethinë.

Bazuar në Rregulloren dhe arësisht nga lokacioni propozohen tri forma të objekteve montuese(kioskat) si në vijim:

Forma e parë e objektit montues, madhësia e të cilit mund të shkojë deri në 30m².



1. Lokacioni i parë është te tregu i gjelbërt-Rr. “Lidhja Prizrenit”.
2. Lokacioni i dytë është kryqzimi i rrugëve Rr. “Lidhja e Prizrenit” dhe Rr. “Tahir Sinani” (zeja e saraqit).
3. Lokacioni tretë është kryqzimi i rrugëve RR. “Skenderbeu” dhe Rr. “Gjergj Fishta”.

Foma e dytë e objektit montues-(Kioskat), madhësia e të cilit mund të shkojë deri në 15m². Në foto është paraqitur një formë e mundshme.



1. Lokacioni i parë është në rr. “Lekë Dukagjini” përball administratës së KUR-Lipjan.
2. Lokacioni i dytë është afër shkollës së mesme “Adem Gllavica” përgjat rrugës rr. “Avdi Kelmendi”.
3. Lokacioni i tretë është në oborrin e shtëpisë së kulturës përgjatë rrugës Rr.“Avdi Kelmendi”.
4. Lokacioni i katërt është në oborrin e tregut të gjelbërt Rr. “Lidhja e Prizrenit”.
5. Lokacioni i pestë është në rr. “Lidhja e Prizrenit” përball SH. “Adem Jashari” (te cigareshitësit).
6. Lokacioni i gjashtë është në kryqzimin rr. “Lidhja e Prizrenit” dhe rr. “Gjergj Fishta”.
7. Lokacioni i shtatë është në rr. “Lidhja e Prizrenit” afër Stacionit të policisë(ekzistues)
8. Lokacioni i tetë është afër kryqëzimit të rrugës “Skenderbeu” me rrugën “Iliria”.

PAISJET LËVIZËSE

Në bazë të Rregullores konsiderohen objektet të cilat mund të zhvendosen nga njëri vend në tjetrin si psh: vitrinat, raftet reklamuese, tavolinat para lokaleve, tendat e hapura lëvizëse dhe të gjitha paisjet e tjera lëvizëse të përcaktuara me nenin 8 të Rregullores.

Këto objekte mund të vendosen për periudë dy vjeçare në lokacionet e përshtatshme bazuar në formën e dhe strukturën e tyre, pas lëshimit të lejes përkatëse nga Komisioni që formohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.

Llojet e paisjeve lëvizëse madhësia e të cilit mund të shkojë deri në 2 m² mund të jenë si në formën në vijim:



TERASAT HOTELIERE

Terasat hoteliere janë objekte që vendosen pranë objekteve hoteliere gjatë sezonit veror dhe dimëror me ose pa rrethojë xhami nga kuota 0.00 deri në 1.7 metra, siq përcaktohen me nenin 9 të Rregullorës.

Terasat hoteliere në formë të tendave dhe mbulesave duhet të jenë fleksibile dhe të njëjta për nga forma, ndërsa ngjyra e tyre pëcaktohet me lejen të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm.

Tendat dhe mbulesat hoteliere propozohen të jenë të njëjta për të gjitha objektet hoteliere, në mënyrë që të paraqesin një pamje të harmonizuar.

Bazuar në nenin 18 par.18.4 lidhur me nenin 9 të Rregullores, terasat hoteliere vendosen për periodë dy vjeçare pas lëshimit të lejes përkatëse nga Komisioni që formohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.

Forma e një terase hoteliere-tende paraqitet si në vijim:



MBULESAT PËR STREHIMIN E NJERËZVE NË TRANSPORTIN PUBLIK (BUS STACIONET)

Mbulesat për strehimin e njerëzve në transportin publik (**bus stacionet**) edhe me këtë plan përcaktohet se ato do të mbeten në vendet ku gjenden aktualisht në vendstacionet e autobusëve. Në prezntimin grafik të mëposhtëm janë të paraqitura keto objekte.




PAISJET PËR LOJËRA FËMIJËSH

Paisjet për lojëra fëmijësh nënkuptohen luhajat, trenat lëvizës, shkallët dhe topoganët. Këto mund të vendosen pranë parqeve që janë të përfunduara siq janë në parkun “Ismet Asllani” dhe pranë parqeve që mund të ndërtohen në të ardhmen.

Bazuar në nenin 18 par.18.4 lidhur me nenin 11 të Rregullores, terasat hoteliere vendosen për periudhë dy vjeçare pas lëshimit të lejes përkatëse nga Komisioni që formohet nga Drejtorati për Shërbime Publike. Paisjet sezonale të cilat shfrytëzohen gjatë sezonit verorë mund të vendosen në lokacionet në lokacionet e mëposhtme që nuk pengojnë aktivitet tjera shoqërore dhe lëvizjen e lirë të njerëzve.

Lokacioni i parë është parkingu që shfrytëzohet nga Shoqatat e dala nga lufta afër stacionit hekurudhor, lokacioni i dytë është hapësira e tregut të gjelbër dhe lokacioni tretë oborri i shtëpisë të kuturës.



GËRMIMI, SHTRIRJA E RRJETIT KABLLOR

Gërmimi dhe shtrirja e rrjetit kabllor që parashihet me nenin 13 të Rregullores sipas kërkesave të distributorëve si KED'S, PTK, Televizionet dhe internet kompanitë bëhet pas marrjes së lejes përkatëse nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

ANTENAT SATELITORE

Janë objekte për emetimin e valëve të cilat vendosen me qëllim të emetimit të valëve të mjeteve të teknologjisë informative. Për vendosjen e tyre në pronat publike duhet të merret leja nga DPUMM vetëm pas lëshimit të lejes nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

III. PROPOZIMI

Komisioni pas analizimit të gjendjes në terren propozon që parkingjet në disa korsi të rrugëve të bëhen me një pagesë simbolike e cila do të ndikonte direkt në rregullimin e parkingut në qytet dhe të rendit në komunikacion, dhe njëkohësisht do të krijoheshin disa vende pune bazuar në lokacionet që mund të zonohen në qytet.

Në këtë zonim përfshihen korsitë e rrugëve të cilat shfrytëzohen për parking si psh Rr. “Skenderbeu”, Parkingjet e planifikuara ekzistuese dhe lokacionet e përbashkët, siq është parkingu në hapësirën e përbashkët publike-private te objekti i dhënë me koncesion “Eurokos”.

IV. PËRFUNDIMI

Për çdo çështje që nuk është përcaktuar me këtë plan, zbatohen dispozitat e Rregullores 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, në bazë të së cilës është hartuar plani.

Ky është një plan gjeneral për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronat publike, ndërsa për vendosjen dhe finalizimin e secilit lloj të objektit siq janë përshkruar në këtë plan duhet të bëhen në faza të veqanta-plan i veqant për secilin lloj të objektit siq përshkruhen në vijim:

1. Paisjet reklamuse dhe informuese
2. Qoshqet
3. Objektet e përkohëshme montuese
4. Paisjet Lëvizëse.
5. Terasat Hoteliere.
6. Mbulesat për strehimin e njerëzve në transportin publik.
7. Paisjet për lojrash fëmijësh.
8. Kabina telefonike.
9. Gërmimi, shtrirja e rrjetit kabllor
10. Antenat satelitore.
11. Përmendoret, pllakat përkujtimore dhe paisje të ngjajshme.

Bazuar në të dhënat e përgjithshme të prezentuara në këtë Raport Komisioni në përbërje të plotë vendosi që Raporti të dorëzohet i kompletuar në këtë formë.

1. Bajram Sinani _____
2. Behar Krasniqi _____
3. Jeton Zymeri _____
4. Ilir Shala _____
5. Kushtrim Salihu _____